



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 02.05.2023

Nr: 75

Ora: 15:10

VENDIM

**PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS NR. 15, DATË 26.04.2023 TË KOMISIONERIT SHTETËROR TË
ZGJEDHJEVE**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 02.05.2023, me pjesëmarrjen e:

Ilirjan	RUSMALI	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

OBJEKT: Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ ndaj z. Nuri Belba, kryetar i bashkisë Prrenjas; ndaj zj. Urjeta Kurti, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Dibër; ndaj z. Bajram Pishkashi, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike



në bashkinë Librazhd, si dhe ndaj zj. Erisa Qalliu, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Lushnje.

BAZË LIGJORE:

Neni 19, pika 1, shkronja “c” dhe neni 21, pika 1, shkronja “dh” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Rrethanat e çështjes:

1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka marrë denoncime për organizimin e katër veprimtarive publike nga katër institucione publike, konkretisht për bashkitë Prrenjas, Dibër, Librazhd dhe Lushnje, për të cilat pretendohet se janë shkelur parashikimet e nenit 91 dhe nenit 92 të Kodit Zgjedhor.
2. Mbi këtë bazë, Komisioneri ka nisur hetimin administrativ ndaj personave përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në katër institucionet shtetërore. Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioneri ka vënë në lëvizje KAS-in me anë të një kërkesë, duke kërkuar marrjen e masës administrative me gjobë ndaj personave përgjegjës përkatës për raportimin e veprimtarive publike të bashkisë Dibër, bashkisë Librazhd, si dhe bashkisë Lushnje në masën 5.000 (pesë mijë) lekë, si dhe ndaj kryetarit të bashkisë Prrenjas në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë.
3. KAS-i caktoi me short z. Ilirjan Rusmali relator për shqyrtimin e kërkesës nr. 15, datë 26.04.2023 të Komisionerit dhe në seancën paraprake vendosi pranimin për shqyrtim të kërkesës, duke e caktuar seancën e shqyrtimit më 02.05.2023, ora 15:10.
4. Seanca e datës 02.05.2023 u zhvillua me praninë e Sekretarit të Përgjithshëm të KQZ-së, si përfaqësues i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe të specialistëve të administratës së KQZ-së. Personat përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike të institucioneve përkatëse, të njoftuar rregullisht, nuk u paraqitën në seancën e shqyrtimit.
5. KAS-i mori në shqyrtim dhe administroi:

- Kërkesën nr. 15, datë 26.04.2023 të Komisionerit;
- Vendimin e Komisionerit nr. 411 datë 25.04.2023 “Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve”;
- Denoncimin nr. 221 ID për bashkinë Librazhd;
- Denoncimin nr. 282 për bashkinë Prrenjas;
- Denoncimin nr. 320 ID për bashkinë Dibër;
- Denoncimin nr. 220 ID për bashkinë Kavajë;

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve përfundimtare,

KAS-i konstaton:

1. Hetimi administrativ i zhvilluar nga Komisioneri për denoncimet Nr. 220 ID, bashkia Lushnje, 221 ID, bashkia Librazhd dhe 320 ID, bashkia Dibër, ka mundur të provojë pasaktësi/parregullsi në raportimin e veprimtarive publike. Parregullsitë kanë lidhje me referimin e natyrës së veprimtarisë, me rrethin e pjesëmarrësve, dhe/ose datën e zhvillimit të veprimtarisë.
2. Komisioneri ka vlerësuar se parregullsitë janë të një natyre të tillë që ose kanë sjellë shmangie/anashkalim nga detyrimet strikte ligjore (detyrimi për raportimin në jo më pak se 5 ditë nga kryerja), ose kanë penguar KQZ-në në gjykimin paraprak që ka detyrë të bëjë për lejueshmërinë e veprimtarisë, sipas pikës 4 të nenit 92 të Kodit Zgjedhor.
3. Shkeljet e konstatuara janë hetuar dhe provuar saktë nga ana e Komisionerit dhe KAS-i i gjen propozimet e Komisionerit për marrjen e masave administrative për rastet e denoncimeve Nr. 220 ID, bashkia Lushnje, 221 ID, bashkia Librazhd dhe 320 ID, bashkia Dibër, të mbështetura në ligj dhe në prova.
4. KAS-i konstaton se për denoncimin nr.221 ID, bashkia Librazhd, mungojnë të dhënat për hetimin dhe arsyetimin juridik lidhur me denoncimin për përdorim të kundërligjshëm të

aseteve publike (veprimtaria e denoncuar është ndarë dhe publikuar në faqen zyrtare të bashkisë, veprimtaria elektorale është zhvilluar në mjediset e shkollës 9-vjeçare Mirakë-Plane). Ky fakt e bën të pamundur gjykimin nga ana e KAS-it për këtë pjesë të denoncimit, sa kohë që në shqyrtimin në KAS të kërkesës mungon denoncuesi si palë procedurale.

5. Kërkesa e Komisionerit për vendosjen e sanksionit administrativ lidhur me denoncimin nr. 282 ID, bashkia Prrenjas, është bërë për shkak se *“përdorimi i aktivitetit të organizuar nga një organ publik, përbën përdorim burimesh publike në kuptim të nenit 91 të Kodit Zgjedhor”*. Veprimtaria e denoncuar, inspektim punimesh dhe bashkëbisedim me banorët e fshatit Rashtan, është zhvilluar në datën 05.04.2023. Në këtë veprimtari ka marrë pjesë drejtuesi politik i PS për qarkun Elbasan, Sekretari i përgjithshëm i Partisë Socialiste, z. Damian Gjijnuri.
6. KAS-i nuk mundi të sigurojë shumicë vendimmarrëse për gjykimin e kërkesës për marrjen e masës administrative ndaj z. Nuri Belba, kryetar i bashkisë Prrenjas. Anëtarët Elvis Çefa dhe Ledio Braho ishin të mendimit se kërkesa e Komisionerit duhet të pranohet, kurse anëtarët Elvin Lako dhe Ilirjan Rusmali ishin të mendimit se kërkesa e Komisionerit duhet të rrëzohet. Për këtë shkak, në vijim do të jepet i ndarë arsyetimi lidhur me këtë kërkesë, në fillim me argumentet për pranimin e kërkesës dhe në vijim me argumentet për rrëzimin e saj.
7. Anëtarët **Elvis Çefa** dhe **Ledio Braho** mbështetën qëndrimin për marrjen e masës administrative ndaj z. Nuri Belba, kryetar i bashkisë Prrenjas. Nga fjala e drejtuesit politik të Partisë Socialiste Qarku Elbasan, z. Damian Gjijnuri, në aktivitetin objekt shqyrtimi administrativ, që është publikuar në rrjetin e tij social *Facebook*, vërehet se ndër të tjera ai është shprehur si vijon *““(…) E tha vetë Nurja dhe një nga arsytet pse ne e kemi mbështetur atë është realisht, që roli i bashkisë është të mirë administrojë fondet lokale, **qeveria qendrore do e mbështesë me projektet më të mëdha kryesore. Dhe në këtë binom duam ta lidhim shumë mirë, pra punën e mirë të bashkisë, projektet e kryetarit, mbështetjen nga qeveria qendrore me projekte të tjera. Kështu që, thashë puna flet vetë, kjo është një punë e filluar dhe jam i bindur që ky është modeli jonë i vazhdueshëm edhe për katër vitet e tjera. Punë, punë, punë, ndryshime në infrastrukturë, investime serioze për të ndryshuar jetën e fshatit, pastaj fshati është i zoti i vetes i del për zot punëve të tij. **Alternativat e tjera politike janë alternativa që*****

nuk i interesojnë Prrenjasit, janë alternativa që e çojnë mbrapa, dhe kjo zonë do patjetër binomin Prrenjas bashki e mirë administruar nga Partia Socialiste mbështetje e qeverisë qendrore dhe këto janë veprat që po i shikojnë gjithë qytetarët sot.”

Siç rezulton nga përmbajtja e fjalimit të drejtuesit politik të Partisë Socialiste për Qarkun Elbasan në aktivitetin e sipërcituar që është organizuar nga Bashkia Prrenjas, ai karakterizohet nga doza të forta politike dhe elektorale nga përfaqësuesi politik i PS në Elbasan apo dhe me mesazhe kundër kandidatëve të tjerë.

Komisioni Rregullator pranë KQZ, në zbatim të detyrimeve të parashikuara nga nenet 90 dhe 92 të K.Zgjedhor, ka nxjerrë vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencie, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”. Në nenin 1 të këtij vendimi që përcakton qëllimin dhe objektin e tij, Komisioni Rregullator, ka përcaktuar se ky akt normativ është nxjerrë “... ***me synim garantimin dhe sigurimin e paanshmërisë dhe trajtimit të barabartë të kandidatëve dhe të partive politike, krijimin e kushteve të drejta e të barabarta për të gjithë kandidatët dhe partitë politike që marrin pjesë në procesin zgjedhor, si dhe për mospërdorimin e fondeve dhe të burimeve publike për qëllime partiake***”. Në nenin 7 shkronjat “dh” dhe “e” të këtij vendimi ku parashikohen ndër të tjera dhe detyrat e kryetarëve të bashkive, citohet se “1. ***Sekretarët e përgjithshëm të institucioneve publike qendrore e vendore, të pavarura e të varësisë, kryetarët e bashkive, prefektët, drejtuesit e njësive administrative dhe drejtuesit e institucioneve të varësisë: ... dh) marrin masa për ndalimin e iniciativave elektorale ndikuese, diktuese dhe urdhëruese apo të propagandës politike, në funksion të fushatës zgjedhore, në institucionet publike përkatëse; e) marrin masa dhe realizojnë monitorimin e zbatimit të tyre, për të penguar keqpërdorimin dhe garantuar mospërdorimin e: ...v) veprimtarisë shtetërore për të favorizuar subjekte të caktuara zgjedhore***”.

Për ne, është e qartë që shfrytëzimi i aktivitetit të organizuar nga Bashkia Prrenjas për përcjelljen e mesazheve elektorale propagandistike apo për të anatemuar kundërshtarin politik

të partisë politike që ka mbështetur dhe mbështet kryetarin e bashkisë në detyrë, cënon sigurimin e paanshmërisë dhe trajtimit të barabartë të kandidatëve dhe të partive politike dhe krijon kushte të pabarabarta (disfavorizuese) për kandidatët e tjerë apo për partitë e tjera politike që marrin pjesë në zgjedhje. Nëse një sjellje e tillë e një kryetari bashkie nuk do të konsiderohej në kundërshtim me qëllimin dhe objektin e vendimit të sipërcituar të Komisionit Rregullator, atëherë duhet të pranojmë se kemi të bëjmë me një akt normativ të pazbatueshëm. Po në të njëjtin përfundim do të dilej edhe në lidhje me nenin 91 të K.Zgjedhor nëse do të pranohet që aktivitete si ato të organizuara nga Bashkia Prrenjas nuk cënojnë sigurimin e paanshmërisë dhe trajtimit të barabartë të kandidatëve dhe të partive politike. Është alogjike të mendosh se një aktivitet i organizuar nga Bashkia Prrenjas, mund të organizohet pa përdorur asnjë burim të saj, në kuptim të burimeve sipas nenit 91 të K.Zgjedhor. Dy janë mundësitë për të organizuar aktivitete të tilla: 1. Aktivitet i organizuar nga Bashkia Prrenjas dhe që ka përdorim të burimeve të Bashkisë Prrenjas; ose 2. Aktivitet politik i kandidatit për Bashkinë Prrenjas me burime që duhet të deklarohen nga partia politike që e mbështet ose vetë kandidati në kuptim të fushatës zgjedhore. Një aktivitet me status të ndryshëm nga këto më sipër, nuk mund të ketë ku organizator të jetë Bashkia Prrenjas apo Kryetari i Bashkisë Prrenjas.

Ndaj, për sa më sipër, KAS duhet të pranonte kërkesën e KSHZ për vendosjen e sanksionit administrativ ndaj Kryetarit të Bashkisë Prrenjas, z. Nuri Belba.

8. Anëtarët **Elvin Lako** dhe **Ilirjan Rusmali** mbështetën qëndrimin e tyre në arsyetimin se pika 1 e nenit 91 nuk lejon që kryetari i bashkisë të përdorë ose të vërë në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve **NË ZGJEDHJE** burime të institucionit që drejton, si në formën e aseteve, ashtu dhe në formën e burimeve njerëzore. Asetet i ka përcaktuar neni 142 i Kodit Civil. Ato janë sende të luajtshme apo të paluajtshme. Veprimtaria në vetvete nuk është send, nuk formon aset, nuk mund të jetë burim, për pasojë nuk mund të bëjë pjesë në objektin e dispozitës së nenit 91, pika 1. Gjatë veprimtarisë mund të përdoren sende, të cilat formojnë asete dhe që janë burime. Por këto sende duhet të identifikohen, të saktësohet pronësia apo të drejtat reale të bashkisë mbi to, përpara se veprimtaria të konsiderohet veprimtari e ndaluar dhe kryetari i bashkisë të merret në përgjegjësi administrative.

9. Lista e veprimtarive të ndaluara, sipas pikës 1 të nenit 3 të vendimit të Rregullatorit nr. 9, datë 24.12.2020, është listë e numërtuar (nga “a” tek “dh” e nën pikës 1.3), sikurse është e numërtuar lista e veprimtarive të ndaluara për t’u promovuar (nga “a” tek “d” e nën pikës 1.1). Kjo do të thotë se llojet e veprimtarive të ndaluara dhe të veprimtarive të ndaluara për t’u promovuar janë të përcaktuara në mënyrë strikte. Atyre nuk mund t’u shtohen lloje të reja veprimtarie, nuk mund të pasurohen as nga Komisioneri, as nga KAS-i. Lista mund të pasurohet vetëm në rrugën e amendimit të vendimit të Rregullatorit nr. 9, datë 24.12.2020. *“Përdorimi i aktivitetit të organizuar nga një organ publik”* nuk bën pjesë në listën e veprimtarive sipas nën pikës 1.3 të pikës 1 të nenit 3, nuk formon dot “veprimtari të ndaluar”.
10. Veprimtaria e denoncuar është një veprimtari me karakter të qartë politik/elektoral. Ajo është zhvilluar në kuadër të veprimtarive politiko-elektorale të Partisë Socialiste, gjegjësisht në dobi të saj. Ndryshe nuk ka shpjegim, as justifikim, pjesëmarrja në veprimtari e drejtuesit politik të Qarkut Elbasan. Pjesëmarrja e kryetarit të Bashkisë Prrenjas, gjithashtu, mund të vlerësohet në këtë kontekst, sa kohë që kryetari i bashkisë ka qenë në momentin e zhvillimit të veprimtarisë (data 05.04.2023) kandidat i subjektit “Partia Socialiste” për zgjedhjet e datës 14 maj 2023. Veprimtaritë në dobi të subjektit politik nga ana e këtyre zyrtarëve shtetërorë nuk janë, në vetvete, të kundërligjshme. Vetëm koha kur kryhen ato mund të shkaktojë përplasje me ligjin.
11. Pika 1 e nenit 91 të Kodit Zgjedhor përcakton se “...nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve **NË ZGJEDHJE** burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia”. Kjo dispozitë është përsëritur në mënyrë të ngjashme edhe nga vendimi i Rregullatorit nr. 9, datë 24.12.2020 në përkufizimin e “veprimtarive të ndaluara” kur ndalon “vënien në dispozicion të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme ... për **QËLLIME ZGJEDHORE**”.
12. Kodi ka përcaktuar periudhën e fushatës zgjedhore, si një periudhë që zgjat nga 30 ditë para datës së zgjedhjeve, deri 24 orë para datës së zgjedhjeve (neni 77), ka përcaktuar periudhën kur nuk lejohet propozimi, miratimi ose nxjerrja e akteve të caktuara ligjore ose nënligjore, e

cila është katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve (pika 4 e nenit 91), por nuk ka përcaktuar periudhën kur vepron ndalimi sipas pikës 1 të nenit 91, kur fillojnë **“ZGJEDHJET”** dhe as kur mbarojnë ato. Nga ana tjetër nuk ka asnjë akt me karakter normativ nga ana e KQZ-së që të përcaktojë momentin kur fillon të veprojë ndalimi i përdorimit të burimeve të organeve apo enteve publike që kërkon ky nen. Vendimi i Rregullatorit nr. 9, datë 24.12.2020 nuk e ka saktësuar këtë përkufizim. Në nënpikën 1.3, të pikës 1 të nenit 3 të tij, teksa jep përkufizimin e **“veprimtarive të ndaluara”**, vendimi vendos afatin për të cilin vepron ndalimi për secilën nga kategoritë e veprimtarive të ndaluara, me përjashtim të veprimtarive të përkufizuara nga shkronja **“c”** dhe nga shkronja **“dh”** e tij, për të cilat nuk ka afat.

13. Në kushtet e mungesës së një përcaktimi detyrues që do t’u vendoste fillimin e veprimit të afatit të ndalimit në një datë më të hershme, subjektet zgjedhore dhe institucionet janë të lira ta çojnë afatin në limitin e tij ligjor, që është data e fillimit të fushatës zgjedhore, d.m.th. 30 ditë përpara datës së zgjedhjeve. Kjo nuk do të formonte shkelje të ligjit, sepse **“PERIUDHA E FUSHATËS ZGJEDHORE”**, sikurse është përcaktuar nga Kodi Zgjedhor e mbulon konceptin **“ZGJEDHJE”** të pikës 1, të nenit 91. Veprimtaria e denoncuar me nr. 282 ID është zhvilluar 9 ditë përparë datës kur fillonte **“periudha e fuashtës zgjedhore”**.
14. KAS-i mund të marrë masa administrative ndaj subjekteve ose përfaqësuesve të institucioneve vetëm nëse konstaton shkeljen e dispozitave të caktuara detyruese ligjore, por nuk mund të sanksionojë administrativisht për veprime, të cilat nuk është ligjërish e qartë nëse janë kryer brenda apo jashtë periudhës së ndalimit. Kuadri ligjor i paqartë nuk mund të zbatohet në dëm të subjekteve. Ndëshkim pa shkelje dhe pa faj nuk mund të ketë.
15. Nëse kuadri rregullator i zgjedhjeve do ishte kompletuar edhe me përkufizimin e afatit kur fillon të veprojë ndalimi sipas pikës 1 të nenit 91, duke e lidhur atë me periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve, atëhere veprimtaria e denoncuar do të ishte **“veprimtari e ndaluar”**, në kuptimin e shkronjës **“c”** të nënpikës 1.3 të pikës 1 të nenit 3 të vendimit të Rregullatorit nr.9, datë 24.12.2020.

16. Pika 2 e nenit 3 të vendimit të Rregullatorit nr. 9, datë 24.12.2020 përcakton se zyrtarët e lartë të Ekzekutivit dhe titullarët e një numri institucionesh “e kanë të ndaluar të drejtojnë, të marrin pjesë apo të kontribuojnë në çfarëdolloj forme, në veprimtari publike të ndaluara ... gjatë periudhës kohore 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve”. Kjo dispozitë ndaluese është vendosur rishtazi me vendimin e Rregullatorit nr. 9, datë 24.12.2020, por nuk ka referencë korresponduese në ndonjërin nga dispozitat sanksionuese të Kodit Zgjedhor. Kjo mungesë mund të sjellë zbatimin inkoherent të sanksioneve administrative, në rastin më të keq, me standard të dyfishtë.
17. Pika 1 e nenit 172 të Kodit Zgjedhor përcakton se “subjektet zgjedhore kryejnë kundërvajtje administrative në rastet kur në favor të tyre kryhen shkelje të ndalimeve të përcaktuara në dispozitat e këtij ligji dhe subjektet zgjedhore, pas marrjes dijeni, nuk marrin masa të menjëhershme për ndërprerjen e shkeljes”. Zhvillimi i “veprimtarive të ndaluara” dhe, eventualisht, pjesëmarrja apo kontributi në çfarëdolloj forme i zyrtarëve të lartë të Ekzekutivit dhe titullarëve të institucioneve të përcaktuara në pikën 2 të nenit 3 të vendimit të Rregullatorit nr. 9, datë 24.12.2020, në veprimtari publike të ndaluara, gjatë periudhës kohore 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve bëjnë pjesë tek “ndalimet e përcaktuara në dispozitat e këtij ligji”. Kjo do të thotë se hetimi administrativ për zhvillimin e veprimtarive të ndaluara apo për rolin e zyrtarëve të lartë të Ekzekutivit a të titullarëve të institucioneve në to duhet të shoqërohet në çdo rast edhe me hetimin për rolin e subjektit zgjedhor përfitues nga veprimtaria. Në përfundim të hetimit administrativ si Komisioneri, ashtu dhe KAS-i duhet të mbajnë qëndrim dhe vlerësim të shprehur për këtë rol.
18. Pika 1 e nenit 171 të Kodit Zgjedhor përcakton sanksionin për shkeljet e kryera “nga anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve ose nga PERSONA TË NGARKUAR ME DETYRA, sipas këtij Kodi”. Personat e ngarkuar me detyra formojnë një listë personash/institucionesh të cilët janë ngarkuar me detyra nominalisht nga Kodi Zgjedhor. Të tillë janë p.sh. vëzhguesit a perfaqësuesit e subjekteve zgjedhore në KQZ (për etikën e punës e të komunikimit), Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (për dërgimin e të dhënave nga regjistri për ndarjen e zonave të administrimit zgjedhor, për listën e zgjedhësve etj), zyra e gjendjes civile dhe kryetari i bashkisë (për listën e zgjedhësve), kryetari i bashkisë (për caktimi e qendrave të votimit),

Ministri që ka në varësi shërbimin e gjendjes civile (për nxjerrjen e urdhërave për listat dhe zonant e qendrave të votimit) etj. Fakti se ata dhe detyrat e tyre përcaktohen nga Kodi do të thotë se lista e tyre është e fundme dhe nuk mund të shtohet me ndonjë akt tjetër ligjor ose nënligjor. Titullari i institucionit apo entit që ka në administrim aset in publik nuk bën pjesë në listën e “personave të ngarkuar me detyra, sipas Kodit”. Sanksioni për të nuk mund të vendoset sipas pikës 1 të nenit 171 të Kodit Zgjedhor. Dispozita e aplikueshme për sanksionim mbetet ajo e pikës 2 të nenit 171.

19. Bazuar në këtë analizë të fakteve dhe të kuadrit ligjor, anëtarët Elvin Lako dhe Ilirjan Rusmali nuk e gjetën të mbështetur kërkesën për vendosjen e sanksionit administrativ ndaj kryetarit të bashkisë Prrenjas dhe as procedimin e subjektit zgjedhor përfitues. Në mungesë të përcaktimit ligjor të afatit kur vepron ndalimi sipas pikës 1 të nenit 91 të Kodit Zgjedhor, është e pamundur që veprimtaria e denoncuar të cilësohet “veprimtari të ndaluar”, përveçse pasi të ketë filluar “periudha e fushatës zgjedhore”.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 21, pika 1, shkronja ‘dh’, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

V E N D O S I:

1. Pranimin e pjesshëm të kërkesës së Komisionerit për vendosjen e sanksioneve administrative.
2. Rrëzimin e kërkesës për vendosjen e sanksionit administrativ ndaj z. Nuri Belba, kryetar i bashkisë Prrenjas, për shkak të mungesës së numrit të kërkuar të votave për vendimmarrje.
3. Vendosjen e sanksionit administrativ ndaj zj. Urjeta Kurti, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Dibër, në masën 5 000 (pesë mijë) Lekë.
4. Vendosjen e sanksionit administrativ ndaj z. Bajram Pishkashi, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Librazhd, në masën 5 000 (pesë mijë) Lekë.

5. Vendosjen e sanksionit administrativ ndaj zj. Erisa Qalliu, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Lushnje, në masën 5 000 (pesë mijë) Lekë.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga shpallja e tij.

Ilirjan	RUSMALI	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar